



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-21-0166**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**S R** Prizren, i përfaqësuar nga avokati **Shaip Ramadani**, nga Prizreni, lagjja Ortakoll, lamela III/II, nr.24.

***kundër***

***E paditura***

**NSH, "Lavërtaria dhe Blegtoria"**, Prizren (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0434 të datës 16 shkurt 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

## **A K T V E N D I M**

**1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**

- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0434 të datës 16 shkurt 2021.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim tek gjyqtari përkatës i shkallës së I-rë të DHPGJS-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 07 prill 2015, paditësi e ka dorëzuar me postë një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0103 i datës 06 mars 2015, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara, për periudhën nga viti 2004 e deri në vitin 2013, në shumë prej 19.013,20 euro. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se kërkesa për këto paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi e kundërshton vendimin e ankimuar dhe konstatimin se kërkesa është parashkruar duke pohuar se në procedurën e likuidimit nuk njihet instituti i parashkrimit të kërkesave të kreditorëve deri në përfundimin e likuidimit. Tutje ai në ankesë pohon se në procedurë të likuidimit paraqiten kreditorët dhe punëtorët të cilëve nuk u janë paguar të ardhurat personale. Paditësi konsideron se me vendimin e Autoritetit të Likuidimit janë shkelur të drejtat fundamentale nga marrëdhënia e punës. Bashkë me këtë ankesë ai dorëzon autorizimin e avokatit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 06.09.2013, kopjen e letër njoftimit, kopjen e njoftimit të AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave në procedurë të likuidimit, kopjen e njoftimit të AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe një kopje të listës së pagave nga e cila nuk mund të shihet se nga kush është lëshuar dhe nuk janë vërtetuar me ndonjë vulë të NSH-së.

Me datë 03 shkurt 2021, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për këto tri paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 16 shkurt 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0434, ankesën e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi nuk ka sjellë ndonjë provë që vërteton se ai e ka ndërprerë parashkrimin për pagat të cilat ai i kërkon për periudhën 2004 – 2013, andaj është i drejtë konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së. Paditësi nuk ka vepruar sipas kësaj dispozite, andaj me të drejtë kërkesa është refuzuar si e pa bazuar për shkak të parashkrimit.

Me datë 15 mars 2021, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimi të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-0434 të datës 16 shkurt 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimin i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të anulohet Aktgjykimin i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimin i ankimuar ka të meta të shumta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, e posaçërisht dispozitivin e Aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në Aktgjykim, ose nuk ka fare arsye për faktet vendimtare. Paditësi pohon se ai me padi kërkoj nga Gjykata që të shfuqizohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, me të cilën kërkesa e tij pa ndonjë bazë është refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ai ka të drejtën në këto paga për kohën sa ka punuar në NSH si punëtor krahu. Tutje paditësi pohoi se Gjykata e Shkallës së I-rë nuk

muarr për bazë Njoftimin AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, i cili ka ndodhë si pasojë e procesit të privatizimit të NSH-së. Tutje ai pohon se në dosje të lëndës kanë qenë edhe listat të pagave për vitet 2004 – 2013, të pa paguara për shkak të insolvencës së NSH Lavërtari dhe Blegtori, në Prizren. Padiësi po ashtu pohon se Libreza e punës në NSH i është mbyllur me datë 06.09.2013, për shkak të privatizimit të ndërmarrjes. Në ankesë po ashtu pretendon se ai ka shqetësime për sigurinë juridike, sepse vëren se Gjykata për raste të njëjta ka vendosur ndryshe, duke përmendur rastin C-IV-13-3731, C-IV-13-2700, etj.

Me datë 06 maj 2021, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e padiësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet anuluar dhe lëndën duhet kthyer në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 19 gusht 2014, e ka dorëzuar një kërkesë që ti paguhen pagat e pa paguara për periudhën nga viti 2004 e deri në vitin 2013, në shumë prej 19.013,20 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit, me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të dorëzuar me datë 07 prill 2015, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së sipas të njëjtës bazë ligjore e refuzon ankesën dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi bashkë me ankesë ka dorëzuar, autorizimin e avokatit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 06.09.2013, kopjen e letër njoftimit, kopjen e njoftimit të AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave në procedurë të likuidimit, kopjen e njoftimit të AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe një kopje të listës së pagave nga e cila nuk mund të shihet se nga kush është lëshuar dhe nuk janë vërtetuar me ndonjë vulë të NSH-së. Këto prova fare nuk janë marrë në konsiderim nga ana e Shkallës së I-rë dhe as nuk janë dhënë arsye pse nuk janë administruar këto prova.

Kolegji i Apelit nuk mund të pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkallës së I-rë se kërkesa për tërë periudhën kohore është parashkruar, duke e marrë për bazë faktin se paditësi kërkesën e ka dorëzuar me datë 19 gusht 2014, dhe pagat i kërkon për periudhën 2004 de në vitin 2013. Shihet qartë se të gjitha pagat në periudhën e cekur nuk janë parashkruar, pasi që nuk kishte kaluar afati tri vite i parashkrimit.

Kolegji i Apelit vlerëson se me këto prova ende nuk ka mundësi të vendoset në merita të ankesës, pasi që ende nuk ka dëshmi relevante që vërtetojnë se cila ishte lartësia e pagës e paditësit dhe cili është detyrimi financiar i NSH-së për pagat e periudhës që ende nuk janë parashkruar. Paditësi i ka ofruar disa lista të

pagave të pa vërtetuara, të pa nënshkruara nga askush, dhe si të tilla në këtë fazë të procedurës ende nuk janë të besueshme.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vendos të aprovon ankesën si të bazuar, të anulon Aktgjykimin e ankimuar dhe padinë ta kthej në rigjykim tek Gjyqtari përkatës i Shkallës së I-rë, i cili në procedurën në vazhdim duhet marrë në konsideratë provat ekzistuese dhe provat tjera që duhet ti sjell paditësi lidhur me lartësinë e pagës mujore të tij si dhe lartësinë e detyrimit të përgjithshëm financiar të NSH-së ndaj tij, dhe pastaj në bazë të provave që duhet të administrohen, të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 28 maj 2021, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_

